



Raport Konsultativ

Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike

SHTET9 (2015-2016)

Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të KOSTT (Viti Relevant 3)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit.
Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

09 mars 2015



Përmbajtja

1	Pasqyrë e Rregullimit të Çmimit	3
2	Hyrje	4
3	Struktura e këtij dokumenti.....	4
4	Balanca e Energjisë.....	4
4.1	Humbjet e Lejuara në Transmision	6
4.2	Humbjet e Lejuara në Shpërndarje	6
5	Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT)....	6
5.1	Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes (OPMct).....	7
5.2	Zhvlerësimi i lejuar (DEPct).....	8
5.3	Kthimi i lejuar i kapitalit (RTNct).....	9
5.4	Kostoja e lejuar e Shërbimeve Ndihmëse (ASVct)	9
5.5	Kostoja e lejuar e humbjeve (LSSct)	11
5.6	Kostoja e lejuar e taksës për licencë (LICct)	Error! Bookmark not defined.
5.7	Të hyrat e lejuara për Mekanizmin për kompensim ndër-OST (ITCRt)	12
5.8	KREVt.....	12
6	Përmbledhje e MAR të KOSTT	12



Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është aktualisht duke i zhvilluar proceset e Përshtatjes së Rregullta dhe Azhurnimit Vjetor të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të Kompanive të Rregulluara në Sektorin e Energjisë Elektrike në kuadër të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE9). Si pjesë e këtij procesi, ZRRE do të azhurnojë MAR e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE) dhe do të përshtatë MAR e Gjeneratorit të Rregulluar (KEK), Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) bazuar në shifrat e caktuara në Shqyrtimin Periodik të bërë në kuadër të SHTE7. Ky Raport Konsultativ paraqet vlerësimin e ZRRE-së të cfarëdo përshtatjeve të nevojshme të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të KOSTT. Së bashku me këtë raport, ZRRE do të publikojë vlerësimin e tyre të MAR të Gjeneratorit të Rregulluar, OSSH dhe FPEE.

Komentet e palëve të interesit

ZRRE beson fuqimisht se konsultimi publik qëndron në thelb të politikave efektive rregullative. Me këtë, ZRRE i jep Kompanive të Rregulluara dhe Konsumatorëve mundësinë të shqyrtojnë të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsultativ, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe t'i komentojnë ato duke përmirësuar gabime eventuale, duke dhënë kundër-argumente apo duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE ndoshta ende nuk i ka konsideruar. Palët të cilat dëshirojnë të shprehin mendimin e tyre mbi pozicionin e ZRRE ftohen ti dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se **23 mars 2015**. Përndryshe, komentet mund të dërgohen edhe me postë tek:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12
Prishtinë, 10000, Kosovë

Dokumente Relevante

Vlerësimi fillestar i ZRRE-së të formularëve të raportimit të KOSTT, të dorëzuara në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik	http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/english/Vleresimi_fillestar_per_KOSTT_anglisht.pdf
Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së të MAR të KOSTT në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Provisional_Evaluation_KOSTT_eng.pdf
Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të MAR të KOSTT në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_KOSTT_22_March_2013.pdf
Rregulla për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (Rregulla për Çmime të OST/OT)	http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/TSO-MO_Pricing_Rule.pdf
Aplikacioni i KOSTT i dorëzuar në kuadër të procesit të Përshtatjes së tretë të Rregullt (SHTE9)	



1 Pasqyrë e Rregullimit të Çmimit

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është institucioni i pavarur i cili përcakton rregullimin e çmimit për kompani të rregulluara të cilat operojnë në tregun e rregulluar të energjisë elektrike në Kosovë. Idealisht, ZRRE do të përcaktonte vetëm çmimet për ato segmente të sektorit të energjisë elektrike të cilat janë monopole natyrale (rrjetet e Transmisionit dhe Shpërndarjes). Megjithatë, pasi që konkurrenca në Gjenerim dhe Furnizim ende nuk është zhvilluar në nivelin i cili do të prodhonte çmime konkurrense, ZRRE i rregullon këto segmente poashtu, duke caktuar tarifa të cilat sigurojnë mbrojtje për konsumatorët për sa i përket çmimeve të caktuara në mungesë të konkurrencës.

Rregullimi i çmimeve është mjete që përdoren nga ZRRE në mënyrë që të caktohet shuma e parave (Të Hyrat Maksimale të Lejuara – MAR), të cilat Kompanitë e Rregulluara lejohen ti mbledhin përmes tarifave për ofrimin e një shërbimeve të rregulluara. MAR caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike duke analizuar hollësisht shpenzimet dhe investimet të cilat Kompanitë planifikojnë t'i bëjnë përgjatë periudhës rregullative. Niveli i MAR caktohet në mënyrë që kompanitë të lejohen t'i mbulojnë kostot e arsyeshme të operimit dhe mirëmbajtjes së impianteve dhe të kenë kthim të arsyeshëm në kapital nëse i realizojnë investimet e aprovuara fillimisht. Gjithashtu, ZRRE përcakton caqe të efikasitetit, të cilat synojnë të ngrisin efikasitetin operativ të kompanive dhe të ofrojnë stimulime apo sanksione nëse kompanitë dështojnë t'i arrijnë këto caqe.

Shqyrtimi i fundit Periodik është bërë nga ZRRE në 2012/2013(SHTE7) dhe ka caktuar MAR e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për një periudhë pesë vjeçare deri më 2017. Duke e kuptuar nevojën për programe të investimeve kapitale intenzive që nevojiten për të përmirësuar sigurinë e furnizimit dhe për të mirëmbajtur infrastrukturen e vjetëruar të transmisionit, ZRRE ka aprovuar planet e KOSTT për të investuar mbi €120 milion përgjatë periudhës pesë vjeçare.

Tabela 1 MAR i KOSTT në një shikim të shpejtë

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT)	
Investimet e parashikuara (2013-2017)	Më shumë se €120 milion përgjatë periudhës pesë vjeçare
Projektet kyçe	Linja 400 kV në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, përmirësime SCADA/EMS & Telecom; tre 110/10(20) kV nënstatione në Gjilan, Palaj dhe Prishtinë; linja e re 110 kV nga SS Peja 3 tek 110/35 kV SS Peja 1.
Nxitjet e efikasitetit	Faktori i efikasitetit vjetor prej 4%, i aplikuar në të gjitha kostot e operimit dhe mirëmbajtjes të Gjeneratorit të Rregulluar përgjatë pesë viteve; Ndëshkime apo shpërblime varësisht nga arritja apo mosarritja e OST të cakut nxitës të humbjes së energjisë elektrike, të caktuar nga ZRRE;



2 Hyrje

Procesi i Shqyrtimit Periodik, i bërë nga ZRRE në vitin 2013, kishte caktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për një periudhë pesë vjeçare deri më 2017. Sipas Rregullës për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, brenda secilit nga ato pesë “Vite Relevante” në mes të 2013 dhe 2017, ZRRE do të ndërmerr një proces të “Përshtatjes së Rregullt”. Ky proces ndryshon nga Shqyrtimi Periodik, në atë që procesi i Përshtatjes së Rregullt nuk përmban një analizë të detajuar të planeve investive dhe të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Në vend të kësaj, Përshtatja e Rregullt përdor rezultatet e marra gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe e përshtat MAR për të reflektuar kostot të cilat ishin parashikuar gjatë Shqyrtimit Periodik dhe kostot aktuale të realizuara nga të licencuarit për shkak të arsyeve jashtë kontrollit të të licencuarit. Gjatë procesit të Përshtatjes së Rregullt të KOSTT, ZRRE do të:

1. Indeksujë Kostot e Lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes për të gjithë të licencuarit me Faktorin e Efikasitetit, të caktuar gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik, dhe me Inflacionin Vjetor, të caktuar duke u bazuar në Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – për të gjitha njësitë në Eurozonë;
2. Caktojë Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSCt) për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), dhe t’i azhurnojë këto në mënyrë që të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve për Periudhën paraprake Rregullative, të cilat mund të kenë lindur si rezultat i ndryshimeve në kostot e blerjes së energjisë me shumicë apo i ndryshimeve në rrjedhat e energjisë elektrike në sistemin e transmisionit
3. Azhurnojë MAR e KOSTT-it në mënyrë që të reflektojë të hyrat e gjeneruara nga Mekanizmi për kompenzim ndër-OST;
4. Azhurnojë MAR e KOSTT-it në mënyrë që të reflektojë ndryshimin në mes të të Hyrave të Rregulluara të Lejuara dhe të Realizuara në Vitin paraprak Relevant (t-1);

3 Struktura e këtij dokumenti

Ky raport konsultativ është i organizuar si vijon:

- Pjesa 4 parashtron Balancën e Energjisë të supozuar nga ZRRE për Vitin e tret Relevant;
- Pjesa 5 rishikon aplikacionin e KOSTT për MAR dhe jep propozimin e ZRRE-së për MAR-in e KOSTT;
- Pjesa 6 jep përmbledhje të propozimeve të ZRRE-së;

4 Balanca e Energjisë

Balanca e Energjisë e përdorur për llogaritjen e Kostos mesatare me shumicë kryesisht i referohet balancës zyrtare të energjisë të aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2015¹. Balanca

¹<http://bit.ly/17YNZn3>



e përdorur për llogaritjen e WHPC është ndërtuar duke përdorur qasje poshtë-lartë me nivelet e eksporteve të shfrytëzuara si faktor balancues në mes të ofertës dhe kërkesës brenda vendit:

- Balanca fillon nga niveli i parashikuar i shitjeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike në aplikacionin e tyre; ndryshe prej herave të tjera, kur ZRRE i ishte referuar balancës së MZHE-së për parashikimin e shitjeve, kësaj rradhe ZRRE ka marrë si referencë parashikimin e KEDS pasi që balanca e MZHE-së kishte paraparë rritje të shitjeve në nivel prej 17.9% që ZRRE e konsideron tejet optimist.
- Niveli i lejuar i humbjeve nga ZRRE është kalkuluar duke i shtuar kërkesës në nivel të shpërndarjes prodhimin e kësaj rradhe në shpërndarje;
- Kërkesa totale në nivelin e shpërndarjes plus kërkesa në nivelin e transmisionit krahasohet me parashikimin e neto prodhimit vendor dhe importin në balancën e energjisë. Ndryshimi mbulohet nga eksportet.

Balanca e energjisë e përdorur për llogaritjen e WHPC është dhënë më poshtë:

Tabela 2 Balanca e Energjisë e përdorur për llogaritjen e Kostove të Blerjes së Energjisë me Shumicë të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike

Balanca e Energjisë		SHTE8 Lejuar	SHTE8 Jashteza.	SHTE8 Realizuar	SHTE9 Propozuar
Gjenerimi KEK		5,525.0	5,098.1	4,858.0	5,570.9
Kosova A	GWh	1,929.0	1,502.1	1,508.9	1,755.6
Kosova B	GWh	3,595.95	3,595.95	3,349.07	3,864.81
Ko-gjenerimi	GWh				-49.49
Gjenerimi tjetër i kyçur në Transmision					
HC Ujmani	GWh	82.0	82.0	101.5	84.0
Kërkesa e kyçur në Transmision		617.1	617.1	622.9	723.6
Konsumi i Ferronikelit	GWh	526.7	526.7	537.0	632.0
Trepca	GWh	27.1	27.1	85.9	25.9
Sharrcem	GWh	63.3	63.3		65.8
Konsumi tjetër në nivel të Transmisionit		283.1	283.1	227.7	272.1
Konsumi i minierës	GWh	138.0	138.0	112.3	138.0
Kosova A – furnizimi nga Transmisioni	GWh	53.2	53.2	76.5	42.2
Kosova B – furnizimi nga Transmisioni	GWh	91.9	91.9	39.0	91.9
Humbjet në Transmision	%	1.8%	1.8%	1.8%	1.8%
	GWh	109.0	107.0	108.8	110.9
Energjia që hyn në Sistemin e Transmisionit		6,057.2	5,942.7	5,916.4	6,162.9
Eksportet	GWh	599.0	486.5	451.9	638.3
Prodhimi total	GWh	5,607.0	5,180.1	4,959.5	5,654.9



Importet	GWh	450.3	762.7	867.5	508.0
Energjia e nevojshme në nivelin e transmisionit	GWh	1,608.2	1,493.7	1,411.4	1,744.9
Energjia e nevojshme në nivelin e shpërndarjes	GWh	4,449.1	4,449.1	4,504.9	4,418.0
Gjenerimi në shpërndarje					
Gjenerimi i kyçur në shpërndarje	GWh	46.3	46.3	49.9	46.6
Wind Power sh.a..	GWh				
Konsumi në shpërndarje	GWh	4,495.4	4,495.4	4,554.8	4,464.6
Humbjet në shpërndarje dhe energjia e pa fatuar					
Humbje teknike dhe komerciale	%	25.6%	25.6%	31.11%	23.13%
	GWh	1,098.2	1,098.2	1,346.2	979.0
Furnizime të pa fatuara	%	4.69%	4.69%	4.99%	5.21%
	GWh	211.0	211.0	227.3	232.5
Humbje totale	GWh	1,309.2	1,309.2	1,573.5	1,211.4
Shitje tek konsumatorët final	GWh	3,186.2	3,186.2	2,981.3	3,253.1

4.1 Humbjet e Lejuara në Transmision

KOSTT nuk e ka raportuar nivelin e humbjeve të realizuara gjatë Vitit të dytë Relevant në përqindje. Niveli i Lejuar i Humbjeve në Transmision është vendosur të jetë 1.8% siç ishte përcaktuar gjatë Procesit të Shqyrtimit Periodik.

4.2 Humbjet e Lejuara në Shpërndarje

Caku i humbjes në shpërndarje është llogaritur duke zbritur 2.5% (pikë përqindje) nga caku i humbjes në shpërndarje i zbatuar në humbjet teknike dhe komerciale, caktuar në kuadër të Shqyrtimit SHTE8. Caku i humbjes është reduktuar në përputhje me Vendimin 399² të bordit të ZRRE, i cili kishte caktuar parametrat rregullativ dhe inputet nxitëse për Periudhën Rregullative dhe Shqyrtimin SHTE6. Caku i lejuar paraprakisht prej 25.6% (pa përfshirë furnizimet e pa fatuara) tani është reduktuar në 23.1%.

5 Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT)

Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) janë të caktuara gjatë Shqyrtimeve Periodike për të gjitha Vitet Relevante të Periudhës Rregullative sipas Rregullës për vendosjen e Çmimeve të KOSTT. ZRRE i përdor të dhënat mbi kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes dhe mbi investimet kapitale të aprovuara gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe i azhurnon ato që të reflektojnë, mes të tjerash, inflacionin e lejuar.

² http://ero-ks.org/Vendimet/Shqip/2012/V_399_2012.pdf



Në secilën Përshtatje të Rregullt, MAR e KOSTT ri-caktohet sipas formulës në vijim (Shtojca 1 Paragrafi 2 i Rregullës për vendosje të Çmimeve të KOSTT):

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + ASVC_t + LSSC_t + LICC_t - ITCR_t + KREV_t$$

Ku

MAR_t	janë të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant t
$OPMC_t$	janë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant t
$DEPC_t$	është zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t
$RTNC_t$	është kthimi i lejuar i kostos së kapitalit në vitin relevant t
$ASVC_t$	është kostoja e lejuar për shërbime ndihmëse në vitin relevant t
$LSSC_t$	është kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t
$LICC_t$	është kostoja e taksës për licencë në vitin relevant t
$ITCR_t$	janë të hyrat neto të OST/OT nga mekanizmi kompensues ndër-OST në vitin relevant t
$KREV_t$	është faktori korrigjues i të hyrave në vitin relevant t

Logaritja e secilës nga këta komponentë të MAR është e dhënë më poshtë.

5.1 Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes (OPMCt)

Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes caktohen gjatë secilës Përshtatje të Rregullt përmes formulës në vijim (Shtojca 1 Paragrafi 2.1 i Rregullës për Çmime të KOSTT):

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

Ku

$OPMC_t$	janë kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant t
$OPMC_{t-1}$	janë kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik
CPI_{t-1}	është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, e matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë në Eurozonë" të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë vlerësim tjetër i inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit



në kostot të operimit dhe mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që është e lejuar gjatë shqyrtimit periodik

E_t është Faktori i Efikasitetit në vitin relevant t , i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

P_t është faktori profilizues në vitin relevant t , i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

Formula e lartcekur supozon se ZRRE do të profilizojë³ lejinin e OPMCt gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik. Pasi që OPMCt nuk është profilizuar, kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes për Vitin e dytë Relevant janë llogaritur si shuma e shifrës së lejuar nga ZRRE në Modelin e Përmbledhur e shumëzuar me normën e inflacionit plus kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes për Vitin e tret Relevant. ZRRE ka vazhduar të aplikojë faktorin e efikasitetit të caktuar në Shqyrtimet Periodike prej 4% në vit dhe një normë të inflacionit sipas Eurostat-it është 0.43%⁴ të llogaritur nga Indeksi i Harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve për të gjitha njësitë në Eurozonë.

ZRRE e ka llogaritur lejinin e OPMCt për Vitin e dytë Relevant të KOSTT me formulën në vijim:

$$OPMC = OPMC_{t-1} * (CPI_{t-1}) * (1 - E_t) + OPMC_t$$

Niveli i lejuar i OPMCt është €6.9 milion.

5.2 Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt)

Zhvlerësimi i lejuar caktohet gjatë secilës Përshtatje të Rregullt përmes formulës në vijim (Shtojca 1 Paragrafi 2.2 i Rregullës për vendosje të Çmimeve të KOSTT):

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku

$DEPC_t$ është zhvlerësimi tjetër i lejuar në vitin relevant t , i cili zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative

$DEPC_{t-1}$ është zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant $t-1$, përveç vitit relevant 1 ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga Rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik, e cila zbutet ashtu që të jetë konstante përgjatë periudhës rregullative

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant $t-1$, matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i

³ ZRRE mund ta aplikoj faktorin profilizues në mënyrë që të minimizojë ndryshime të konsiderueshme në mes të vitit të fundit të periudhës së tanishme rregullative dhe vitit të parë të periudhës së ardhshme rregullative.

⁴ http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=prc_hicp_manr&lang=en



P_t është faktori profilizues në vitin relevant t , i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

Kjo formulë, siç është e caktuar në Rregullën për vendosjen e Çmimeve, përsëri supozon se lejimi i zhvlerësimit është profilizuar përgjatë periudhës rregullative. Pasi që nuk është aplikuar faktori profilizues gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik, aplikimi i formulës ashtu siç është në Rregullën për vendosjen e çmimeve nuk do të përputhej me lejimet e DEPCt për Vitin e tret Relevant. Për këtë arsye, ZRRE ka adoptuar formulën në vijim:

$$DEPC = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t$$

Kostot e lejuara të zhvlerësimit për Vitin e tret Relevant janë €6.2 milion.

5.3 Kthimi i lejuar i kapitalit (RTNCt)

Indeksi i komponentës së Kthimit të lejuar të kapitalit për inflacion është llogaritur me formulën në vijim (Shtojca 1 Paragrafi 2.3 i Rregullës për vendosje të Çmimeve të KOSTT):

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku

$RTNC_t$ është kthimi i lejuar i kapitalit në vitin relevant t , i cili zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative

$RTNC_{t-1}$ është kthimi i lejuar i kapitalit në vitin relevant $t-1$, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant $t-1$, matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i

P_t është faktori profilizues në vitin relevant t , i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

Sikurse në llogaritjen e komponentëve OPMct dhe DEPCt, ZRRE nuk ka profilizuar Kthimin e lejuar të kapitalit gjatë Shqyrtimit Periodik. Formula e lartcekur supozon se komponenti i kthimit të lejuar nuk është profilizuar dhe prandaj aplikimi i saj strikt çon në një situatë ku KOSTT nuk e merr kthimin e plotë të lejuar. Për këtë arsye, kjo komponentë është llogaritur me formulën në vijim:

$$RTNC = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + (RTNC_t)$$

Kthimi i lejuar i kapitalit për KOSTT për Vitin e tret Relevant është €2.7 milion.

5.4 Kostoja e lejuar e Shërbimeve Ndhmëse (ASVct)

Duke filluar nga prilli 2015, KOSTT pret të lidhë kontrata për ofrimin e rezervave sekondare dhe terciare. Ofrimi i këtyre rezervave është obligim për anëtarësim në Rrjetin European të Operatorëve



të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO-E), të cilit KOSTT tani i është bashkuar. Detajet mbi llojet e ndryshme të kërkesave të rezervave mund të mirren nga webfaqet e ENTSO-E apo KOSTT.

Këto kontrata do t'i kenë dy ngarkesa. E para është taksa e disponueshmërisë, ekuivalente me ngarkesën e kapacitetit për gjeneratorë, të cilat kompenzojnë ofruesin për kostot e mbajtjes së kapacitetit të mjaftueshëm në dispozicion për t'i përmbushur kërkesat e rezervës. E dyta është taksa e shfrytëzimit, e paguar kur rezervat janë vërtetë të kërkuara nga Kosova. Kjo është në fakt çmimi marginal i tregut të energjisë në periudhën relevante, i cili përfaqëson koston e blerjes së energjisë shtesë për t'i kompensuar mungesat. Taksat e disponueshmërisë dhe të shfrytëzimit janë të lidhura – në orët pik çmimi i tregut të energjisë, dhe rrjedhimisht, i taksës së shfrytëzimit do të jetë më i lartë. Këto të hyra më të larta të pritura nga taksa e shfrytëzimit do të thotë se taksa e disponueshmërisë e kërkuar nga ofruesi mund të jetë më e ulët, duke iu lejuar atyre që prapë se prapë t'i mbulojnë kostot e veta në tërësi.

Taksa e disponueshmërisë do të përfshihet në ngarkesat e shfrytëzimit të sistemit të transmisionit (TUOS) dhe për këtë arsye, kostot e pagesave të disponueshmërisë do të përbëjnë një pjesë të MAR të KOSTT. Është e nevojshme që këto kosto të socializohen pasi që përfaqësojnë koston e sigurimit që rezervat të jenë në dispozicion kur të nevojiten – gjë që është përfitim shoqëror.

Kostot e shfrytëzimit të rezervave (taksa e shfrytëzimit) do të mbulohen përmes tregut balancues. Aty ku, për shembull, një gjenerator është i mangët (gjeneron më pak se që është nominuar), KOSTT mund të përdorë rezerva të kontraktuara për të kompensuar mungesën rezultuese në furnizim. Do të duhet të paguajë taksën e shfrytëzimit për të bërë këtë. Kostot e kësaj pagese do t'i ngarkohen gjeneratorit i cili shkaktoi debalancin. Kjo ofron nxitje për pjesëmarrësit që të mbesin në balancë. Prandaj, këto kosto nuk bëjnë pjesë në MAR të KOSTT pasi që nuk mbulohen nga ngarkesat TUOS, por janë të alokuara, në momentin kur realizohen, tek pala e cila e krijon nevojën për shfrytëzimin e rezervave.

KOSTT ka dhënë vlerësime të pagesave të disponueshmërisë të asociuara me blerjen e rezervave sekondare dhe terciare. ZRRE i ka rishikuar këto dhe i ka përshtatur si në vijim.

- KOSTT ka vlerësuar pagesat në bazë mujore. Pastaj i ka mbledhur këto dhe ka shumëzuar totalin rezultues me 0.75 për të bërë përshtatje për fillimin e pritur të kontratës dikur më vonë gjatë vitit. Megjithatë, kjo i zvogëlon ndikimet e mos-kontraktimit nga janari deri në mars pasi që kërkesat e rezervave janë më të larta gjatë këtyre muajve (për shkak të kërkesës më të lartë). Në vend të kësaj, ZRRE i ka zbritur kostot e vlerësuara të rezervave në janar, shkurt dhe mars për të marrë koston totale që do të mbulohet nga ngarkesat TUOS.
- KOSTT ka supozuar se rezervat terciare do të nevojiten vetëm gjatë orëve të pikut, por ka aplikuar taksën e disponueshmërisë të aplikueshme në të gjitha orët për t'i kalkuluar kostot e këtyre rezervave. Siç është diskutuar më lartë, çmimet e tregut të energjisë dhe, rrjedhimisht, të taksave të shfrytëzimit do të jenë më të larta në orët e pikut dhe taksa përkatëse e disponueshmërisë do të jetë më e ulët. ZRRE ka korigjuar këtë me rikalkulimin e



kostove e rezervave duke supozuar një taksë të disponueshmërisë që është konsistente me kontratat për orët e pikut.

Ndikimet e këtyre përshtatjeve janë për t'i zvogëluar kostot e vlerësuara të kontratave të rezervave që do të përfshihen në MAR të KOSTT nga propozimi fillestar prej €5.45 milion në €3.86 milion.

5.5 Kostoja e lejuar e humbjeve (LSSCt)

Kostoja e lejuar e humbjeve për OST është kalkuluar duke përdorur cakun e humbjes së lejuar në kuadër të SHTE8 duke përdorur formulën në vijim (Shtojca 1 Paragrafi 2.4 i Rregullës për vendosje të Çmimeve të KOSTT):

$$LSSC_t = LSSA_t * REUE_t * WHEA_t + (LSSCa_{t-1} - LSSCf_{t-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$

Ku

$LSSC_t$	është kostoja e lejuar e humbjeve për vitin relevant t
$LSSA_t$	janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e transmisionit në vitin relevant t
$REUE_t$	janë njësitë e energjisë (MWh) që hyjnë në sistemin e transmisionit në vitin relevant t
$WHEA_t$	është mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) e përcaktuar duke përdorur kostot e lejuara me shumicë për FPEE në vitin relevant t
$LSSCa_{t-1}$	është kostoja e realizuar e humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)
$LSSCf_{t-1}$	është kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)
I_t	është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua të afatshkurtra
$LSAC_{t-1}$	është kostoja e humbjeve të realizuara nga OST gjatë blerjes së energjisë nga FPEE si kompensim i energjisë së humbur në rrjetin e transmisionit (nuk llogaritet duke përdorur humbjet e lejuara) në vitin relevant t-1
$LSSF_t$	është faktori i ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike.

Norma e interesit e përdorur për të llogaritur kompensimin në mes të kostove të realizuara dhe të lejuara në Vitin paraprak Relevant është llogaritur duke përdorur S-faktorin të caktuar nga ZRRE



gjatë Shqyrtimit Periodik (15.0%) plus norma aktuale një-vjeçare EURIBOR (0.25%⁵). Norma e interesit që përdoret për përshtatje prandaj caktohet të jetë 15.25%.

Komponenta e parë e formulës LSSCt ($LSSAt * REUEt * WHEAt$) është llogaritur si produkt i nivelit të lejuar të humbjeve (1.8%) i shumëzuar me njësitet e energjisë që hyjnë në sistemin e transmisionit (6162.9 GWh) dhe me Mesataren e Ponderuar të parashikuar të Kostove të Blerjes së Energjisë prej 28.2 €/MWh. Kostoja aktuale e humbjeve (LSSCat-1) duke e përdorur përqindjen e humbjes së lejuar nga ZRRE dhe WHEA-në e lejuar nga ZRRE është €2.9 milion, ndërsa vlera reale e lejuar nga ZRRE (LSSCft-1) për MAR në Vitin Relevant 1 është €3.0 milion. Ndryshimi në mes të LSSCat-1 dhe LSSCft-1 i është kthyer KOSTT me interes. Në ricaktimin e humbjeve të lejuara për Vitin e dytë Relevant (LSSCt), ZRRE gjithashtu ka shtuar ndryshimin në mes të LSSCat-1 dhe LSACt-1. Për këtë arsye, lejimet finale të OST për Vitin e dytë Relevant është €3.0 milion.

5.6 Të hyrat e lejuara për Mekanizmin për kompensim ndër-OST (ITCRt)

Asnjë e hyrë nuk është zbritur për Mekanizmin për kompensim ndër-OST në përputhje me të hyrat e pritura në kuadër të këtij mekanizmi për Vitin e dytë Relevant.

5.7 KREVt

Ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të lejuara nga ZRRE për Vitin e dytë Relevant dhe të të Hyrave të Rregulluara të Realizuara që janë mbledhur nga KOSTT gjatë periudhës së njëjtë është llogaritur sipas formulës në vijim (Shtojca 1 Paragrafi 2.5 i Rregullës për vendosje të Çmimeve të OST/OT):

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

ARR_{t-1} janë të hyrat e rregulluara të realizuara në vitin relevant t-1

MAR_{t-1} janë të hyrat e lejuara maksimale për vitin relevant t-1

I_t është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua të afatshkurtra

Ndryshimi në mes të MAR të lejuar nga ZRRE prej €20.2 milion dhe të ARR të mbledhura nga KOSTT prej €18.8 milion i është kthyer MAR të KOSTT me interes.

6 Përmbledhje e MAR të KOSTT

Niveli i përgjithshëm i MAR të KOSTT për Vitin e dytë Relevant është €25.9 milion siç është e përmbledhur në tabelën në vijim.

⁵Norma Euribor për 19 shkurt 2015 <http://www.euribor-rates.eu/euribor-rate-12-months.asp>



Tabela 3 Përmbledhje e propozimit MAR të KOSTT për Vitin Relevant 3

KOSTT MAR		ETR8 Lejuar	ETR8 Jashtezak.	ETR9 Propozuar
Parametrat e indeksimit				
Faktori i efikasitetit	%	4.00%	4.00%	4.00%
Faktori profilizues		0.00	0.00	0.00
HICP	%	0.70%	0.70%	0.97%
Euribor	%	0.58%	0.58%	0.25%
S-faktori	%	15.00%	15.00%	15.00%
It	%	15.58%	15.58%	15.25%
Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (OPM_{Ct})				
$OPM_{Ct} = OPM_{Ct-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	7.1	7.1	6.9
Zhvlërësimi i lejuar (DEPC_t)				
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	6.6	6.6	7.0
Kthimi i lejuar i kapitalit (RTNC_t)				
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	3.3	3.3	3.6
Shërbimet ndihmëse				
Shërbimet ndihmëse	€m			3.9
Humbjet e lejuara (LSSC_t)				
Humbjet e lejuara				
LSSAt	%	1.8%	1.8%	1.8%
REU _{Et}	GWh	6,057.2	5,942.7	6,162.9
WHEAt	€/MWh	27.3	29.5	28.2
LSSCat-1				
LSSCft-1		3.0		3.0
LSAct-1	€m			
LSSC _t	€m	3.3	3.5	3.0
Shpërblimi për arritjen e caktut të humbjes				



KREV

€m	-0.2	-0.2	1.5
----	------	------	-----

KOSTT MAR

Pärshtatja

€m	20.2	20.4	25.8
----	------	------	------